



## UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA”

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: +383 (0) 280390112

---

### FTESË PËR APLIKIM

Universitetit “Kadri Zeka” i përkrahur nga Komisioni Evropian përmes Projekti Erasmus+ ‘*Klinikat ligjore në shërbim të grupeve të cenushme: rritja e punësueshmërisë së studentëve të drejtësisë përmes arsimit praktik - ENEMLOS*’ ju bënë thirrje studentëve të Fakultetit Juridik që të aplikojnë për të qenë pjesë e Klinikës Juridike me raste reale.

Klinika ligjore (klinika juridike) është ndihmë juridike që ofron shërbime për klientë të ndryshëm, dhe shërben si përvojë praktike ligjore për studentët e Fakultetit Juridik të UKZ-së.

Aktivitetet e ofrimit të ndihmës juridike primare klientëve (intervistat dhe këshillimi) do të mbahen në zyret e klinikave ligjore në Universitetin “Kadri Zeka”.

Studentët klinikë fillimisht do të trajnohen rreth rolit të Klinikës Ligjore me raste reale, do të takohen një herë në javë për ligjëratë dhe diskutime në tryezë të rumbullakët rreth çështje reale që mund të pranojnë nga klientët. Ligjëratat do të mbahen nga stafi akademik dhe ligjërues të ftuar të cilët janë profesionistë ligjorë (prokurorë, avokatë dhe gjyqtarë), përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile dhe të tjerë. Përveç ligjëratave, studentët do të punojnë në ekipe për të adresuar rastet reale të sjella nga klientët.

Çdo student (nën mbikëqyrje), do të angazhohet në një gamë të plotë të detyrave të ndihmës juridike primare:

- Intervistimi dhe këshillimi i klientit;
- Përgatitja dhe argumentimi i mbrojtjes;
- Shqyrtimi i të dhënave, provave etj;
- Hululumtim i ligjit për të siguruar mbështetje për teoritë e ndryshme ligjore;
- Asistimi në hartimin dhe paraqitjen e shkresave të ndryshme;
- Të marrin pjesë në ligjëratat një herë në javë;
- Të marrin pjesë në aktivitete promovuese rreth rolit të Klinikës Juridike Reale, dhe të kryejnë punë tjera administrative.

Për të qenë pjesë e Klinikës, Studentët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jenë studentë të vitit të dytë, tretë, katërt të Fakultetit Juridik ose studentë i nivelit Master në Fakultetin Juridik të Universitetit “Kadri Zeka”;
- Zotërojnë aftësi të shkrimit ligjor;
- Zotërojnë aftësi të hulumtimit ligjor;
- Aftësi për të dhënë këshilla ligjore për klientët;
- Të demonstrojnë interes në reformën gjyqësore, angazhim në komunitetit, dhe qasje në drejtësi;
- Të demonstrojnë angazhim për etikë në klinikë;
- Aftësi të mira në të folur dhe shkruar në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës dhe njohja e një gjuhe të huaj është përparësi.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- CV
- Letër motivimi
- Certifikatën e notave

Dokumentet e aplikimit të dorëzohen në zyrën e protokollit, deri më 12 Tetor 2022 në ora 16:00. Në rast të numrit të madh të kandidatëve, vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen.